



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.636/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e kandidatit për deputet Petrit Hajdari nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kundër rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më 18.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pa bazuara ankesat Anr.636/2025, Anr.637/2025, Anr.638/2025 të datës 16.03.2025 të paraqitura nga kandidati për deputet Petrit Hajdari nga radhët e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, kundër rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 16.03.2025, ka pranuar ankesat Anr.636/2025, Anr.637/2025 dhe Anr.638/2025 të parashtruara nga kandidati për deputet Petrit Hajdari nga radhët e PDK-së. Në ankesën Anr.636/2025, pretendohet se më datë 22 shkurt 2025, nga qytetarët Ridvan Islamaj, Zyre Islamaj dhe Selver Islamaj, kam pranuar informatën se në Vendvotimin me nr. 2066/02 në Komunën e Prizrenit, përkundër se të njëjtit kanë votuar për kandidaturën time për deputet, në zgjedhjet e mbajtura më 9 shkurt 2025, pas procesit të numërimit të votave dhe sipas rezultateve të publikuara në platformën zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), figuron se në këtë vendvotim kam marrë vetëm një (1) votë. Të njëjtit, më kanë njoftuar se kandidatura ime është votuar edhe nga disa miq dhe të afërm të tyre, ndërkohë kanë ofruar edhe bashkëpunimin e tyre në funksion të argumentimit të faktit se në këtë vendvotim kam më shumë vota dhe se numri i saktë i votave nuk përkon me rezultatin e publikuar në platformën zyrtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Me qëllim të argumentimit të qëndrueshmërisë së deklaramit të tyre dhe

vërtetimit të pretendimeve, të tre këta qytetarë, i kanë përcjellur edhe kopjet e letërnjoftimeve, me qëllim në mënyrë që PZAP, të ketë mundësi ta bëjë verifikimin nëse të njëjtit janë të regjistruar si votues në Vendvotimin me nr. 2066/02 në Komunën e Prizrenit dhe në këtë mënyrë të vërtetohet fakti se përshkrimi i votave në këtë vendvotim është bërë në mënyrë jo të saktë përkitazi me kandidaturën time. Parashtruesi i ankesës po ashtu thekson se z. Selver Islamaj, ka përpiluar edhe një deklaratë me qëllim të argumentimit të pretendimeve pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me të cilën ka mëtuar të dëshmojë faktin se i njëjti dhe prindërit e tij z. Ridvan Islamaj dhe znj. Zyre Islamaj, kanë qenë votues të subjektit politik "Partia Demokratike e Kosovës - PDK", si dhe kandidatit për deputet nga ky subjekt politik, z. Petrit Hajdari, me numër 51 andaj sipas dokumentit të formalizuar, respektivisht deklaratës së z. Selver Islamaj, datë 23 shkurt 2025, në Vendvotimin me nr. 2066/02 në Komunën e Prizrenit, kandidatura ime ka marrë të paktën tri (3) vota, nga qytetarët z. Ridvan Islamaj, znj. Zyre Islamaj dhe z. Selver Islamaj, e të sipas informacionit të të cilëve kandidatura ime është votuar edhe nga familjarë dhe miq të tyre. Pra, përshkrimi i votave është bërë në mënyrë të gabuar dhe në dëm timin si kandidat. Përfundimisht parashtruesi i ankesës ka kërkuar që PZAP ta urdhëroj KQZ për rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimin e përmendur më lartë. Parashtruesi i ankesës si provë për të dëshmuar deklaratat e mëparshme ka bashkangjitur Rezultatet e votave për kandidat në Vendvotimin me nr.2066/02 në Komunën e Prizrenit, Deklaratën e përpiluar nga z.Selver Islamaj me datë 23 shkurt 2025 në të cilën theksohet Në bazë të të dhënave të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në qendrën e votimit nr. 2066/02, e vendosur në SHFMU "Hasim Maliqaj", Poslishte, Prizren, është evidentuar vetëm një votë, ndërsa të paktën duhej të ishin tre vota nga ne, Për korrektësi edhe familjarët tjerë kanë votuar për numrin 51, por vota të cilat nuk figurojnë. Kjo mospërputhje ngre dyshime mbi saktësinë e numërimit të votave dhe integritetin e procesit zgjedhor. Unë Selver Islamaj, i lindur më 10.09.1982 në Prizren, me numër personal 1006374316, DEKLAROJ se kam votuar së bashku me prindërit e mi: Ridvan Islamaj, i lindur më 22.03.1958, me numër personal 1500098747, Zyre Islamaj, e lindur më 25.02.1963, me numër personal 1500098712. Ne të tre kemi votuar për numrin 131 - Partia Demokratike e Kosovës dhe për kandidatin me numër 51 Petrit Hajdari. Për këtë arsye, kërkojmë nga PZAP që të shqyrtojë këtë çështje dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për korrigjimin e rezultatit dhe evidentimin e saktë të votave tona.

Në ankesën Anr.637/2025 pretendohet se në bazë të të dhënave të publikuara në platformën zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të përgjithshme, datë 9 shkurt 2025, unë, Petrit Hajdari, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik "Partia Demokratike e Kosovës - PDK", me numër 51, kam marrë 16733 vota në nivel të vendit. Sipas informatave të cilat i kemi pranuar nga disa komisionerë dhe vëzhgues, gjatë procesit të numërimit të fletëvotimeve dhe të votave të kandidatëve në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Drenas, janë vërejtur dhe evidentuar parregullsi, me të cilat është cenuar e drejta e votës dhe integriteti i procesit zgjedhor, ndërsa unë si kandidat jam dëmtuar për një numër të caktuar votash, që mund të jetë vendimtar dhe të rezultojë me mbetjen time jashtë listës së kandidatëve të cilat do të certifikohen dhe do të marrin mandatin e deputetit. Kjo, duke marrë parasysh garën e ngushtë dhe diferencën e vogël të numrit të votave ndërmjet kandidatëve. Dyshimet për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave, janë ngritur dhe lidhur me to i është drejtuar me shkresë zyrtare Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), edhe znj. Ardiana Isufi, përfaqësuese e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK),

kryesuese e Ekipit të Numërimit, tavolina m. 2. në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Drenas. Veprimet e caktuara, të cilat ekzistojnë dyshime të bazuara se janë kryer edhe në formë të organizuar në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Drenas, të cilat mund të vërtetohen qoftë edhe përmes pamjeve vizuale, përmbajnë elemente të veprës penale të falsifikimit të votave dhe të rezultateve të zgjedhjeve, me qëllim të regjistrimit në mënyrë të pasaktë apo të manipulimit me rezultatin zgjedhor, të dënueshme edhe me Kodin Nr. 061-074 Penal të Republikës së Kosovës. Veprim tjetër me elemente të ushtrimit të ndikimit dhe keqpërdorimit të autoritetit zyrtar, i shprehur gjatë procesit të numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Drenas, është edhe përfshirja e drejtpërdrejtë e personave të paautorizuar dhe të emëruarve politikë, në procesin e numërimit. Të përsëritur gjatë këtij procesi, kanë qenë jo më pak se drejtorët e drejtorive të Komunës së Drenasit, ndërsa sipas informacioneve të besueshme edhe udhëheqësit e gati të gjitha qendrave të votimit. Ndërsa, të pranishëm kanë qenë edhe persona të pa akredituar dhe vëzhgues të pa certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Parashtruesi i ankesës po ashtu ka theksuar se ka ndodhur përfshirja e personave të paautorizuar në procesin e numërimit të votave dhe se pretendimet tona janë të bazuara dhe për t'u trajtuar meritorisht, është njoftuar edhe opinioni publik, përmes lajmit të publikuar në portalin e mediumit Klan Kosova (shih vegzën: shkelet ligji. të emëruarit politik numërojnë vota (VIDEO) - Klan Kosova) e po ashtu sipas informacioneve të pranuar nga komisionarë dhe vëzhgues, të ngarkuar me detyra zyrtare gjatë procesit të numërimit të votave, por edhe pretendimeve të formalizuara në procedurë administrative nga znj. Ardiana Istufi, janë ndërmarre forma të ndryshme të veprimeve, ndër të cilat shpallja e pavlefshme e fletëvotimeve të rregullta në të cilat është votuar kandidatura ime. Parashtruesi i ankesës nuk e ka theksuar numrin e Vendvotimit po i njëjti është i cekuar në Librin e votimit (vërejtjeve) I bërë nga znj Ardiana Isufi e cila ka deklaruar se në kutinë e votimit 0316/02 gjatë numërimit të votave është vërejtur se janë shpall disa fletëvotime të pavlefshme pikërisht pse është kandidati I PDK-së Petrit Hajdari.

Në ankesën Anr.638/2025 pretendohet se Në bazë të të dhënave të publikuara në platformën zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të përgjithshme, datë 9 shkurt 2025, unë, Petrit Hajdari, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik "Partia Demokratike e Kosovës - PDK", me numër 51, kam marrë 16733 vota në nivel të vendit. Sipas informatave të cilat i kemi pranuar nga disa komisionerë dhe vëzhgues, gjatë procesit të numërimit të fletëvotimeve dhe të votave të kandidatëve në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Drenas, janë vërejtur dhe evidentuar parregullsi, me të cilat është cenuar e drejta e votës dhe integriteti i procesit zgjedhor, ndërsa unë si kandidat jam dëmtuar për një numër të caktuar votash, që mund të jetë vendimtar dhe të rezultojë me mbetjen time jashtë listës së kandidatëve të cilat do të certifikohen dhe do të marrin mandatin e deputetit. Kjo, duke marrë parasysh garën e ngushtë dhe diferencën e vogël të numrit të votave ndërmjet kandidatëve. Këto pretendime, me dyshime për ndërhyrje të qëllimshme në procesin zgjedhor, janë ngritur edhe nga znj. Ardiana Isufi, përfaqësuese e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kryesuese e Ekipit të Numërimit, tavolina nr. 2, në ankesën kundër Qendrës Komunale të Numërimit (QKN) në Drenas. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se ankesa me numër Anr 595/2025, datë 16.2.2025 e znj. Istrefi, është refuzuar si e pabazuar nga ana e PZAP, me Vendimin Anr.595/2025, me arsyetimin se deklaratimet janë bërë pas mbylljes së kutisë së votimit dhe se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për ta bërë të besueshëm pretendimin ankimor. Përfundimisht parashtruesi i ankesës thekson se sipas informacioneve të pranuar nga

komisionerë dhe vëzhgues, të ngarkuar me detyra zyrtare gjatë procesit të numërimit të votave, por edhe pretendimeve të formalizuara në procedurë administrative nga znj. Ardiana Isufi, janë ndërmarrë forma të ndryshme të veprimeve, ndër të cilat shpallja e pavlefshme e fletëvotimeve të rregullta në të cilat është votuar kandidatura ime. Parashtruesi i ankesës nuk e ka theksuar numrin e Vendvotimit po i njëjti është i cekuar në Librin e votimit (vërejtjeve) i bërë nga znj Ardiana Isufi e cila ka deklaruar se në kutinë e votimit 0316/02 gjatë numërimit të votave është vërejtur se janë shpall disa fletëvotime të pavlefshme pikërisht pse është kandidati I PDK-së Petri Hajdari.

Në përgjigjen e KQZ-së, theksohet se lidhur me pretendimet palës ankuese në ankesën Anr.636/2025 se ka pasur parregullsitë gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimin Nr.2066/02 në QKN, në Prizren, si dhe pas shqyrtimit të deklaratave të votuesit të bashkangjitura në ankesën e ankuesit, gjejmë se të njëjtat nuk janë të mjaftueshme për tu konkluduar se në QKN në Prizren ka pasur parregullsi dhe se pretendimet e palës ankuese mbështeten kryesisht në deklaratatë të qytetarëve, të cilat nuk janë të shoqëruara me prova konkrete dhe të verifikueshme. Për më tepër, duhet theksuar se vota është e fshehtë dhe çdo publikim apo deklarim i saj bie ndesh me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës. Prandaj, pohimi i një votuesi se ka votuar në vendvotimin e përmendur nuk mund të merret si provë e vlefshme për të mbështetur pretendimet e ankuesit. Sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me Anr.637/2025, se sipas informatave të vëzhguesve dhe komisionarëve gjatë numërimit të fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve në QKN në Prizren janë vërejtur dhe evidentuar parregullsi të cilat kanë cenuar të drejtën e votës dhe integritetin e procesit zgjedhor, nuk qëndrojnë sepse ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara përveç një prove të bashkangjitur në ankesë në librin e shënimeve, ku vërehet që janë evidentuar disa vërejtje gjatë numërimit të subjekteve politike dhe për kandidatin në fjalë, mirëpo të njëjtin dokument i mungon pjesa e ballinës së Librit të votimit me numrin e vendvotimit, anëtarët ekipit të numërimit, momenti i hapjes së procesit të votimit, mbyllja, data e evidentimit, shkeljet e pretenduar, emri i vëzhguesit dhe cilit subjektet politik i takon e njëjta. Megjithatë, kjo mungesë e specifikimit nuk përbën ndonjë provë që dëshmon parregullsi. Formulari i rezultateve të subjekteve politike, i hartuar nga ekipet e numërimit në Qendrën Komonale të Numërimit (QKN), nuk tregon qartë për cilin vendvotim është përpiluar. Megjithatë, kjo mungesë e specifikimit nuk përbën ndonjë provë që dëshmon parregullsi në procesin e numërimit të votave. Më 15.02.2025, Komisioni Komonale i Zgjedhjeve ka njoftuar KQZ se vendvotimin Nr.0316/02, nuk ka pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale as në ditën e zgjedhjeve, as pas ditës së zgjedhjeve as në procesin e fillimit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe se për këtë KKZ nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese, ku të njëjtën deklaratë KQZ e ka specifikuar edhe në përgjigjen në kërkesë lidhur me ankesën Anr.592/2025 dhe 595/2025. Gjithashtu pretendimet e ankuesit në Anr.638/2025, se sipas informatave të vëzhguesve dhe komisionerëve gjatë numërimit të fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve në QKN në Glllogoc janë vërejtur dhe evidentuar parregullsi të cilat kanë cenuar të drejtën e votës dhe integritetin e procesit zgjedhor, nuk qëndrojnë sepse ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara përveç një prove të bashkangjitur në ankesë në librin e shënimeve, ku vërehet që janë evidentuar disa vërejtje

gjatë numërimit të subjekteve politike dhe për kandidatin në fjalë, mirëpo të njëjtin dokument i mungon pjesa e ballinës së Librit të votimit me numrin e vendvotimit, anëtarët ekipit të numërimit, momenti i hapjes së procesit të votimit, mbyllja, data e evidentimit, shkeljet e pretenduara, emri i vëzhguesit dhe cilit subjekte politik i takon e njëjta. Formulari i rezultateve të subjekteve politike, i hartuar nga ekipet e numërimit në QKN, nuk tregon qartë për cilin vendvotim është përpiluar. Megjithatë, kjo mungesë e specifikimit nuk përbën ndonjë provë që dëshmon parregullsi në procesin e numërimit të votave.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.16 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: A.nr.636/2025, Anr.637/2025, Anr.638/2025 janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.636/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga, nga kandidati për deputet Petrit Hajdari nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë vëren se:

Ankesat janë të pa bazuara.

Pretendimet e parashtruara në ankesa nga kandidati për deputet Petrit Hajdari nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se gjatë procesit të votimit është dëmtuar për një numër të caktuar të votave në dy vendvotime dhe atë në vendvotimin me nr.0316/02 në Komunën e Drenasit dhe vendvotimin nr.2066/02 në Komunën e Prizrenit, Paneli i vlerësoi si të pa bazuara, pasi që nga provat e ofruara nga ana e parashtruesit të ankesës nuk janë vërtetuar këto pretendime.

Andaj nga kjo gjendje faktike, sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me Anr.636/2025, që vendvotimin nr.2066/02 në Komunën e Prizrenit, Paneli ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese për faktin se nuk mund të vërtetohet se të njëjtit votues për cilin subjekt dhe për cilin kandidat kanë votuar, kjo për arsye se fshehtësia e votimit dhe e votës është e siguar me dispozita ligjore. Sa i përket provave të ofruara nga kandidati-ankuesi, përkatësisht deklaratat e tre votuesve se të njëjtit kanë votuar për kandidatin në fjalë dhe i njëjti është dëmtuar me këto tri vota, për panelin nuk mund të merren si prova të bazuara, për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesi përkatës të ketë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit. Për më tepër sipas vlerësimit e Panelit, marrja e deklaratave të tilla e cenon procesin e votimit dhe të drejtën e fshehtësisë së votës të paraparë sipas dispozitave ligjore nga neni 6 par. 2 i LZP-së, që

parasheh se: *Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë*, andaj sipas vlerësimit të panelit këto deklarata bijnë ndesh me dispozitat e lartcekura dhe si të tilla nuk mund të merren si të prova me të cilat mund të vërtetohen shkeljet e pretenduara në vendvotimin Nr.2066/02 në Komunën e Prizrenit.

Po ashtu, sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me Anr.637/2025, dhe Anr.638/2025, se sipas informatave të vëzhguesve dhe komisionarëve gjatë numërimit të fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve në QKN në Drenas janë vërejtur dhe evidentuar parregullsi të cilat kanë cenuar të drejtën e votës dhe integritetin e procesit zgjedhor, Paneli ka vlerësuar se të njëjta nuk qëndrojnë, sepse ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara përveç një prove të bashkangjitur në ankesë në librin e shënimeve, ku vërehet që janë evidentuar disa vërejtje gjatë numërimit të subjekteve politike dhe për kandidatin në fjalë, mirëpo të njëjtin dokument i mungon pjesa e ballinës së Librit të votimit me numrin e vendvotimit, anëtarët ekipit të numërimit, momenti i hapjes së procesit të votimit dhe mbyllja. Po ashtu të njëjtin dokument i mungon data e evidentimit të shkeljeve të pretenduara, emri i vëzhguesit si dhe cilit subjekt i takon e njëjta. Megjithatë, kjo mungesë e specifikimit nuk përbën ndonjë provë që dëshmon parregullsi. Formulari i rezultateve të subjekteve politike, i hartuar nga ekipet e numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), nuk tregon qartë për cilin vendvotim është përpiluar. Paneli vlerëson se pretendimet e njëjta lidhur me këto parregullsi janë trajtuar edhe me ankesën A.nr.592/2025 të datës 18.02.2025

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117 par. 3 të LZP-së, i cili përcakton se "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e tij.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të plotë se pretendimet ankimore janë të pa bazuar në ligj, andaj ankesat u refuzuan si të pa bazuara në kuptim të nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, dhe mbi këto arsye paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 636/2025 më datën 18.03.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.





REPUBLIKAE KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KESHILLI GJYQESOR I KOSOVES/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



GJYKATA SUPREME E KOSOVES

SEKRETARIATI I KESHILLIT GJYQESOR TE KOSOVES

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOKUMENTI DORËZOHET PËR SHËNDRIMIN

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

BA-61/2025

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashur të bëhet dorëzimi i sa pas lehtës së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendur në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit mëdhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fëmijë, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin, primaoca nastojniku zgrade, susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (shke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).
2. Posto primilac odnosno član njegov domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom, mestu primaoca (pribero na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.
Shkakun i refuzimit të marrjes _____
Razlog arhivjanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - poqips dostavljaca

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIVITETI

Numri i shkojçave: _____
broj priloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)

Povrdijerno prijem gorenavegenog pisma
(i slovina) _____


(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Poqips primilaca ili licu koje je
pismeno primilo u zarnenu)

24.03.2025

Nënshkrimi i dorëzuesit - poqips dostavljaca

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtati)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkakuin pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpis, potpisuje ga dostaljac, napomenom žasto primilac nije stavio svoj potpis.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.61/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Rustem Thaqi dhe Delushe Halimi, anëtarë, lidhur me ankesën e kandidatit për deputet Petrit Hajdari nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të rezultatit përfundimtarë të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09.02.2025, e duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.636/2025, të datës 18.03.2025, në seancën e mbajtur më datë, 24.03.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa kandidatit për deputet Petrit Hajdari nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A.nr.636/2025, të datës 18.03.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.636/2025, të datës 18.03.2025, është vendosur: "Refuzohen të pa bazuara ankesat Anr.636/2025, Anr.637/2025, Anr.638/2025 të datës 16.03.2025 të paraqitura nga kandidati për deputet Petrit Hajdari nga radhët e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, kundër rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025."

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidati për deputet Petrit Hajdari nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën i konteston rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve, gjegjësisht pretendon se i njëjti është dëmtuar për një numër të caktuar votash si rezultat i parregullsive me të cilat është cenuar e drejta e votës dhe integriteti i procesit zgjedhor, si pasojë e së cilës i njëjti ka mbetur jashtë listës së kandidatëve të cilët do të certifikohen, dhe atë në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Drenas dhe në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Prizren, me propozim që Gjykata Supreme të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj vendimin A.nr.363/2025, datë 18.03.2025 të PZAP dhe të obligohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për rinumërimin e fletëvotimeve të përmendura më lart, me qëllim të evitimit të çfarëdo tjetërsimi të vullnetit qytetar.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të kandidatit për deputet Petrit Hajdari nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij



të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e kandidatit për deputet Petrit Hajdari nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.363/2025, datë 18.03.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.


Nga shkresat e lëndës rezultojnë se PZAP-i, më datë 16.03.2025, ka pranuar ankesat Anr.636/2025, Anr.637/2025 dhe Anr.638/2025, të parashtruara nga kandidati për deputet Petrit Hajdari nga radhët e PDK-së. Në ankesën Anr.636/2025, pretendohet se më datë 22 shkurt 2025, nga qytetarët Ridvan Islamaj, Zyre Islamaj dhe Selver Islamaj, ka pranuar informatën se në Vendvotimin me nr. 2066/02 në Komunën e Prizrenit, përkundër se të njëjtit kanë votuar për kandidaturën e tij për deputet, në zgjedhjet e mbajtura me 9 shkurt 2025, pas procesit të numërimit të votave dhe sipas rezultateve të publikuara në platformën zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), figuron se në këtë vendvotim ka marrë vetëm një (1) votë. Pastaj ka theksuar se të njëjtin e kanë njoftuar se kandidatura e tij është votuar edhe nga disa miq dhe të afërm të tyre, ndërkohë kanë ofruar edhe bashkëpunimin e tyre në funksion të argumentimit të faktit se në këtë vendvotim ka më shumë vota dhe se numri i saktë i votave nuk përkon me rezultatin e publikuar në platformën zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), duke pretenduar se përshkrimi i votave në këtë vendvotim është bërë në mënyrë jo të saktë përkitazi me kandidaturën e tij. Parashtruesi i ankesës po ashtu thekson se z. Selver Islamaj, ka përpiluar edhe një deklaratë me qëllim të argumentimit të pretendimeve pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me të cilën ka mëtuar të dëshmojë faktin se i njëjti dhe prindërit e tij z. Ridvan Islamaj dhe znj. Zyre Islamaj, kanë qenë votues të subjektit politik "Partia Demokratike e Kosovës - PDK", si dhe kandidatit për deputet nga ky subjekt politik, z. Petrit Hajdari, me numër 51 andaj sipas dokumentit të formalizuar, respektivisht deklaratës së z. Selver Islamaj, datë 23 shkurt 2025, në Vendvotimin me nr. 2066/02 në Komunën e Prizrenit, kandidatura e tij ka marrë të paktën tri (3) vota, nga qytetarët z. Ridvan Islamaj, znj. Zyre Islamaj dhe z. Selver Islamaj, e që sipas informacionit të të cilëve kandidatura e tij është votuar edhe nga familjarë dhe miq të tyre. Pra, ka pretenduar se përshkrimi i votave është bërë në mënyrë të gabuar dhe në dëm të tij si kandidat. Përfundimisht parashtruesi i ankesës ka kërkuar që PZAP ta urdhërojë KQZ për rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimin e përmendur me lartë.

Në ankesën tjetër të kandidatit për deputet Petrit Hajdari nga radhët e PDK-së, Anr.637/2025 pretendohet se në bazë të të dhënave të publikuara në platformën zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të përgjithshme, datë 9 shkurt 2025, Petrit Hajdari, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik "Partia Demokratike e Kosovës PDK", me numër 51, ka marrë 16733 vota në nivel të vendit, ndërsa sipas informatave të cilat i ka pranuar nga disa komisionerë dhe vëzhgues, gjatë procesit të numërimit të fletëvotimeve dhe të votave të kandidatëve në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Drenas, janë vërejtur dhe evidentuar parregullsi, me të cilat është cenuar e drejta e votës dhe integriteti i procesit zgjedhor, ndërsa i njëjti si kandidat është dëmtuar për një numër të caktuar votash, që mund të jetë vendimtar dhe të rezultojë me mbetjen e tij jashtë listës së kandidatëve të cilat do të certifikohen dhe do të marrin mandatin e deputetit. Kjo, duke marrë parasysh garën e ngushtë dhe diferencën e vogël të numrit të votave ndërmjet kandidatëve. Më tej ka pretenduar se



dyshimet për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave, janë kryer edhe në formë të organizuar në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Drenas, të cilat mund të vërtetohen qoftë edhe përmes pamjeve vizuale, përmbajnë elemente të veprës penale të falsifikimit të votave dhe të rezultateve të zgjedhjeve, me qëllim të regjistrimit në mënyrë të pasaktë apo të manipulimit me rezultatin zgjedhor, të dënueshme edhe me Kodin Nr. 061-074 Penal të Republikës së Kosovës, e po ashtu ka pretenduar se në procesin e numërimit, të pranishëm kanë qenë edhe persona të pa akredituar dhe vëzhgues të pa certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në të cilin vendvotim disa fletëvotime janë shpallë të pavlefshme pikërisht pse është kandidati i PDK-së Petrit Hajdari. Ndërsa në ankesën Anr.638/2025 pretendohet në shkelje të njëjta të procesit të zgjedhjeve, me pretendim se i njëjti është dëmtuar me një numër të caktuar votash, që ka rezultuar në mbetjen e tij jashtë listës së kandidatëve të certifikuar.

Në përgjigjen e KQZ-së, theksohet se lidhur me pretendimet e palës ankuese në ankesën A.nr.636/2025, se ka pasur parregullsitë gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimin Nr.2066/02 në QKN, në Prizren, si dhe pas shqyrtimit të deklaratave të votuesit të bashkangjitura në ankesën e ankuesit, të njëjtat nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se në QKN në Prizren ka pasur parregullsi dhe se pretendimet e palës ankuese mbështeten kryesisht në deklaratatë të qytetarëve, të cilat nuk janë të shoqëruara me prova konkrete dhe të verifikueshme. Për më tepër, duhet theksuar se vota është e fshehtë dhe çdo publikim apo deklarim i saj bie ndesh me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës. Prandaj, pohimi i një votuesi se ka votuar në vendvotimin e përmendur nuk mund të merret si provë e vlefshme për të mbështetur pretendimet e ankuesit. Sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me Anr.637/2025, se sipas informatave të vëzhguesve dhe komisionarëve gjatë numërimit të fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve në QKN në Prizren janë vërejtur dhe evidentuar parregullsi të cilat kanë cenuar të drejtën e votës dhe integritetin e procesit zgjedhor, i ka vlerësuar të paqëndrueshme, sepse ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara përveç një prove të bashkangjitur në ankesë në librin e shënimeve, ku vërehet që janë evidentuar disa vërejtje gjatë numërimit të subjekteve politike dhe për kandidatin në fjalë, mirëpo të njëjtit dokument i mungon pjesa e ballinës së Librit të votimit me numrin e vendvotimit, anëtarët e ekipit të numërimit, momenti i hapjes së procesit të votimit, mbyllja, data e evidentimit, shkeljet e pretenduar, emri i vëzhguesit dhe cilët subjektet politik i takon e njëjta. Megjithatë, kjo mungesë e specifikimit nuk përbën ndonjë provë që dëshmon parregullsi dhe se formulari i rezultateve të subjekteve politike, i hartuar nga ekipet e numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), nuk tregon qartë për cilin vendvotim është përpiluar. Megjithatë, kjo mungesë e specifikimit nuk përbën ndonjë provë që dëshmon parregullsi në procesin e numërimit të votave. Më 15.02.2025, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve ka njoftuar KQZ se vendvotimin Nr.0316/02, nuk ka pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale as në ditën e zgjedhjeve, as pas ditës së zgjedhjeve as në procesin e fillimit të numërimit të votave për kandidat në QKN, dhe se për këtë KKZ nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese, ku të njëjtën deklaratë KQZ e ka specifikuar edhe në përgjigjen në kërkesë lidhur me ankesën Anr.592/2025 dhe 595/2025. Gjithashtu pretendimet e ankuesit në Anr.638/2025, se sipas informatave të vëzhguesve dhe komisionarëve gjatë numërimit të fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve në QKN në Gillogoc janë vërejtur dhe evidentuar parregullsi të cilat kanë cenuar të drejtën e votës dhe integritetin e procesit zgjedhor, nuk qëndrojnë sepse ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara përveç një prove të bashkangjitur në ankesë në librin e shënimeve, ku vërehet që janë evidentuar disa vërejtje gjatë numërimit të subjekteve politike dhe për kandidatin në fjalë, mirëpo të njëjtin dokument i mungon



pjesa e ballinës së Librit të votimit me numrin e vendvotimit, anëtarët ekipit të numërimit, momenti i hapjes së procesit të votimit, mbyllja, data e evidentimit, shkeljet e pretenduara, emri i vëzhguesit dhe cilit subjekte politik i takon e njëjta. Formulari i rezultateve të subjekteve politike, i hartuar nga ekipet e numërimit në QKN, nuk tregon qartë për cilin vendvotim është përpiluar dhe se kjo mungesë e specifikimit nuk përbën ndonjë provë që dëshmon parregullsi në procesin e numërimit të votave.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.16 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: A.nr.636/2025, A.nr.637/2025, A.nr.638/2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.636/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga kandidati për deputet Petrit Hajdari nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave, ashtu që të njëjtat i vlerësoj të pabazuara.

Paneli pretendimet e parashtruara në ankesa nga kandidati për deputet Petrit Hajdari nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se gjatë procesit të votimit është dëmtuar për një numër të caktuar të votave në dy vendvotime dhe atë në vendvotimin me nr.0316/02 në Komunën e Drenasit dhe vendvotimin nr.2066/02 në Komunën e Prizrenit, i vlerësoi si të pa bazuara, pasi që nga provat e ofruara nga ana e parashtruesit të ankesës nuk janë vërtetuar këto pretendime. Andaj nga gjendja faktike, sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me ankesën A.nr.636/2025, që i referohen vendvotimit nr.2066/02 në Komunën e Prizrenit, Paneli i ka vlerësuar të paqëndrueshme, për faktin se nuk mund të vërtetohet se të njëjtit votues për cilin subjekt dhe për cilin kandidat kanë votuar, kjo për arsye se fshehtësia e votimit dhe e votës është e siguruar me dispozita ligjore. Paneli më tej ka shtuar se sa i përket provave të ofruara nga kandidati-ankuesi, përkatësisht deklaratat e tre votuesve se të njëjtit kanë votuar për kandidatin në fjalë dhe i njëjti është dëmtuar me këto tri vota, për panelin nuk mund të merren si prova të bazuara, për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesi përkatës të ketë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit. Për më tepër sipas vlerësimit të Panelit, marrja e deklaratave të tilla e cenon procesin e votimit dhe të drejtën e fshehtësisë së votës të paraparë sipas dispozitave ligjore nga neni 6 paragrafi 2 i LZP-së, që parashihet se: “Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”, andaj sipas vlerësimit të panelit këto deklaratat bien ndesh me dispozitat e lartcekura dhe si të tilla nuk i mori si prova me të cilat mund të vërtetohen shkeljet e pretenduara në vendvotimin Nr.2066/02 në Komunën e Prizrenit.

Po ashtu, sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me ankesën A.nr.637/2025, dhe A.nr.638/2025, se sipas informatave të vëzhguesve dhe komisionarëve gjatë numërimit të fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve në QKN në Drenas janë vërejtur dhe evidentuar parregullsi të cilat kanë cenuar të drejtën e votës dhe integritetin e procesit zgjedhor, Paneli ka vlerësuar se të njëjtat nuk qëndrojnë, sepse ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara përveç një prove të bashkangjitur në ankesë në librin e shënimeve, ku vërehet që janë evidentuar disa vërejtje gjatë numërimit të subjekteve.



politike dhe për kandidatin në fjalë, mirëpo të njëjtit dokument i mungon pjesa e ballinës së Librit të votimit me numrin e vendvotimit, anëtarët ekipit të numërimit, momenti i hapjes së procesit të votimit dhe mbyllja. Po ashtu të njëjtit dokument i mungon data e evidentimit të shkeljeve të pretenduara, emri i vëzhguesit si dhe cilit subjekt i takon e njëjta. Megjithatë, kjo mungesë e specifikimit nuk përbën ndonjë provë që dëshmon parregullsi. Formulari i rezultateve të subjekteve politike, i hartuar nga ekipet e numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), nuk tregon qartë për cilin vendvotim është përpiluar. Paneli vlerëson se pretendimet e njëjta lidhur me këto parregullsi janë trajtuar edhe me ankesën A.nr.592/2025 të datës 18.02.2025. Prandaj duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, i cili përcakton se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së kandidatit për deputet Petrit Hajdari, nga Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të rezultatit përfundimtarë të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09.02.2025, respektivisht parregullsive të pretenduara nga ankuesi lidhur me procesin zgjedhor. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara për parregullsi të procesit të votimit në qendrat e votimit në Prizren dhe në Drenas janë vlerësuar të pabazuara. Meqenëse ankuesi në ankesën e paraqitur nuk i është referuar shkeljeve konkrete të dispozitave të procedurës ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, por vetëm çështjeve që kanë të bëjnë me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale, Gjykata Supreme është kufizuar vetëm në trajtimin e këtyre pretendimeve ankimore.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të kandidatit për deputet Petrit Hajdari nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, përkitazi me rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve, respektivisht parregullsitë e procesit zgjedhor, si pasojë e së cilës i njëjti ka mbetur jashtë listës së kandidatëve të cilët do të certifikohen, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, me rastin e refuzimit të ankesës së deputetit të lartcekur, si në vendimin e atakuar, me të drejtë ka vlerësuar se në vendvotimin me nr.0316/02 në Komunën e Drenasit dhe vendvotimin nr.2066/02 në Komunën e Prizrenit, nga provat e ofruara nga ana e parashtruesit të ankesës nuk janë vërtetuar këto pretendime.

Nga kjo rrjedh se është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP, se kandidati për deputet Petrit Hajdari nga Subjekti Politik PDK, lidhur me ankesën e paraqitur A.nr.636/2025, që i referohet vendvotimit nr.2066/02 në Komunën e Prizrenit, nuk ka arritur të vërtetoj faktin se në vendvotimin e lartcekur ka pasur parregullsi, kjo pasi që votuesit, respektivisht deklaratat e tyre se të njëjtit kanë votuar për kandidatin në fjalë nuk mund të merren si prova të bazuara, për faktin se ashtu siç me të drejtë ka konstatuar edhe paneli, në këtë rast nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit. Nga kjo rezulton i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-it, se marrja e deklaratave të tilla e cenon procesin e votimit dhe të drejtën



fshehtësisë së votës të paraparë sipas dispozitave ligjore nga neni 6 paragrafi 2 i LZP-së, që parashihet se: *“Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”*, duke konsideruar se deklaratat e tilla janë në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Pretendimet ankimore lidhur me ankesat A.nr.637/2025 dhe A.nr.638/2025, respektivisht parregullsitë që i referohen numërimit të fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve në QKN në Drenas, nga Gjykata Supreme janë vlerësuar të pabazuara, kjo për faktin se me të drejtë është konstatuar nga PZAP-i se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara përveç një prove të bashkangjitur në ankesë në librin e shënimeve, ku vërehet që janë evidentuar disa vërejtje gjatë numërimit të subjekteve politike dhe për kandidatin në fjalë, mirëpo të njëjtit dokument i mungon pjesa e ballinës së Librit të votimit me numrin e vendvotimit, anëtarët ekipit të numërimit, momenti i hapjes së procesit të votimit dhe mbyllja. Po ashtu të njëjtit dokument i mungon data e evidentimit të shkeljeve të pretenduara, emri i vëzhguesit si dhe cilit subjekt i takon e njëjta, me vlerësim se mungesa e specifikimit nuk përbën ndonjë provë që dëshmon parregullsi të cilat i ka pretenduar ankuesi me ankesë. Për më tepër edhe nga formulari i rezultateve të subjekteve politike, i hartuar nga ekipet e numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), nuk tregon qartë për cilin vendvotim është përpiluar, si rrjedhojë e bën të pabazuar pretendimin e ankuesit lidhur me parregullsitë e pretenduara.

Gjykatës Supreme i rezulton se pretendimet për parregullsitë në procesin e zgjedhjeve lidhur me ushtrimin e ndikimit dhe keqpërdorimit të autoritetit zyrtar, me përfshirje të personave të paautorizuar në këtë proces dhe të emëruar tjerë politik, janë pretendime të pabazuara, pasi që nuk mjafton që pretendimet e tilla vetëm të listohen në ankesë, mirëpo të njëjtat duhet vërtetuar me prova konkrete, e në mungesë të tyre, respektivisht emrave ose shkeljeve tjera apo veprave penale lidhur me procesin zgjedhor, rezultojnë të pabazuara. Kjo për faktin se PZAP-i, me rastin e refuzimit të ankesave të deputetit të lartcekur ka marrë për bazë të gjitha pretendimet, mirëpo në mungesë të provave me të drejtë ka refuzuar ankesën e deputetit në fjalë. Edhe deklarata e z. Selver Islamaj, e datës 23.02.2025 për argumentim të pretendimeve të ankuesit pranë PZAP, se i njëjti së bashku me prindërit e tij z. Ridvan Islamaj dhe znj. Zyre Islamaj kanë qenë votues të Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), si dhe kandidatit për deputet nga ky subjekt Petrit Hajdari, për Gjykatën Supreme nuk qëndron, kjo pasi që me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e po ashtu me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është paraparë se vota është e fshehtë, e rrjedhimisht çdo publikim apo deklaram i saj bie ndesh me parimin kushtetues si dhe ligjin e lartcekur, dhe se deklarata e tillë se votuesi ka votuar në vendvotimin e përmendur nuk mund të merret si provë e vlefshme për të mbështetur pretendimet e ankuesit.

Në lidhje me këtë, me nenin 117 të Ligjit Nr.08/1-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, janë përcaktuar [Procedurat e PZAP-së], ku me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“3. Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse, ndërsa me paragrafin 4 të këtij neni përcaktohet se: PZAP-ja mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtruar”*. Ndërsa, sipas nenit 118 [Vendimet], të këtij ligji përcaktohet se: *“1. PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”*. Sipas nenit 13 paragrafit 2 [Vendimmarrja e PZAP-it], të Rregullores nr.01/2024, të Panelit Zgjedhor për Ankesat dhe Parashtrësia (PZAP), përcaktohet se: *“PZAP-i aprovon ankesat e bazuar në fakte dhe refuzon ankesat në mungesë të provave”*. Mbi këtë bazë kjo gjykatë i ka vlerësuar të pabazuara edhe pretendimet lidhur me atë se



është jo bindës dhe kontradiktorë, kjo për faktin se duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga PZAP, dhe dispozitave të lartcekura, vlerëson se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, nga çka rezulton se vendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe me Rregulloren nr.01/2024, të Panelit Zgjedhor për Ankesat dhe Parashtrësia (PZAP), dhe në mungesë të provave të qëndrueshme ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtrësit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuuan se përnibushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


GJYKATA SUPREME – PRISHTINË
AA.nr.61/2025, datë 24.03.2025

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE


Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik